

me mbështetjen e



Ministria e Zhvillimit Urban prezanton hartën e parë dixhitale dhe interaktive të venddepozitimeve ekzistuese të mbetjeve të ngurta urbane.

Harta evidenton situatën mbi venddepozitimet ekzistuese në të gjithë territorin e vendit. Informacioni është publik për gjithë aktorët e mundshëm si institucione qendrore e lokale, donatorë, investitorë, zhvillues, dhe qytetarë.

Harta do të përdoret si një mjet planifikimi për përcaktimin e njollave ku synohet të ndërtohen landfillet e reja dhe për ndjekjen e zhvillimeve në terren në sektorin e mbetjeve.



**Harta Dixhitale e
Venddepozitimeve të
Mbetjeve**


më shumë



HARTA DIXHITALE E VEND-DEPOZITIMEVE TË MBETJEVE

HARTA DIXHITALE E VENDDEPOZITIMEVE

<http://mbetjet.zhvillimiurban.gov.al>



Procesi i Krijimit të Hartës

Informacioni që përmban harta është siguruar nëpërmjet komunikimit zyrtar midis MZHU-së dhe Njërive të Qeverisjes Vendore.

Janë kryer edhe vizita në terren në:

- 65 bashki,
- 31 komuna me dendësi të lartë.

Pikat në hartë përfaqësojnë:

- 89 venddepozitime jo sanitare,
- 3 venddepozitime në kushte sanitare.


Informacion me i gjerë për secilin venddepozitim gjendet në faqen zyrtare të Ministrisë së Zhvillimit Urban si dhe në adresën:

<http://mbetjet.zhvillimiurban.gov.al>

NJESITE E QEVERISJES VENDORE

Për NJQV-të harta shërben për:

- Evidentimin e gjithë venddepozitimeve që po trashegojnë bashkitë e reja, në territorin e zgjeruar pas reformës administrative territoriale;
- Përcaktimin e zonave ku do të ndërtohen landfillet e reja sipas planeve dhe direktivave në nivel kombëtar;
- Evidentimin e zonave të cilat nuk kanë shërbimin e duhur për shkak të mungesës së infrastrukturës mbështetëse, apo karakterit rural.



INSTITUCIONET QENDRORE

Për institucionet qendrore harta shërben për:

- Mbledhjen e bazës informative gjatë përditësimit të dokumenteve strategjike dhe zhvillimit të politikave të reja mjedisore;
- Orientim mbi caktimin e vendodhjes së projekteve infrastrukturore në nivel kombëtar e rajonal;
- Orinetimin e donatorëve si dhe zhvilluesit e tjerë për të investuar në këtë fushë.



QYTETARET

Për qytetaret dhe shoqërinë civile harta shërben për:

- Tu informuar mbi distancat nga zonat e banuara, liqenet, lumenjtë, si dhe pasuri të tjera natyrore e kombëtare të rëndësishme.
- Tu informuar mbi zhvillime të reja në fushën e mbetjeve si rehabilitimi i venddepozitimeve dhe ndërtimi i landfilleve
- Të ritur ndërgjegjësimin e shoqërisë civile
- Të rritur ndikimin e grupeve të interesit në mirëqeverisje.

